



PROCESVERBAL VIII/2025

I mbajtur me rastin e mbledhjes së VIII (tetë) për vitin 2025 të Komitetit për
Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 07.08.2025
Ora : 10:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues

Të pranishëm tjerë:

z. Urim Suka
znj. Bulëza Kuçi
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Fidaije Kukaj
z. Dardan Berisha
z. Liridon Fandaj

Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend Dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit të Veprimit Komunal për Strehim Familjar për Komunën e Suharekës;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për bonuset e zonimit për Komunën e Suharekës;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-31320;**
- 5. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Suharekës për vitin 2024;**

Sanie Kuqi-Rexhepaj-përshendetë të pranishmit,në mbledhjen e kaluar e kemi pas një pikë të rendit të ditës,puna e raportit të pronave nga Drejtoria e Pronës,në zonën industriale dhe ku do që jan të dhëna në shfrytëzim,raporti u vu në diskutim mirpo me një far lloj mirëkuptimi ne u dakorduam që ajo pikë me ardhë në mbledhjen e radhës dhe nuk pat korum edhe pse ajo pikë nuk ka pas me u votu ,pat qaq shumë asambleista në sallë sa e pam të arsyeshme që me u diskutu në mbledhjen e ardhshme kur jemi në shumicë,po më intereson arsyeja pse nuk ka ardhë sepse vullneti Drejtorit ke për me u diskutu.

Kryesuesi-Ne kur i kemi përpilu pikat e rendit të ditës,i kemi informu Drejtorat për me i sjellë pikat,njëra prej tyre ka qenë pika e tretë me u sjellë edhe njëher dhe tjera nuk ka pas.

Bulëza Kuçi-përshendetë të pranishmit,kur e keni hartu planin e KPF-së aty ka qenë edhe një pikë,që gjatë këtij muaji ka me raportu DKA për gjendjen aktuale dhe gjendjen e viti pasues dhe nuk e pash si pikë të rendit ditës.

Kryesuesi-është e vërtet që ka qenë për muajin Gusht me përgadit një raport Drejtori i Arsimit por as ai nuk e ka sjellë,mirpo ju keni të drejtë me ja bë një shkresë.

Kryesuesi-e hedhë në votim rendin e ditës

Miratohet rendi ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi-e hedhë në votim pikën 1

Unanimishtmiratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit të Veprimit Komunal për Strehim Familjar për Komunën e Suharekës;

Kryesuesi-e laboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka- unë e kam lexu materialin dhe nuk mu ka dukë i qartë ,deshta me e ditë një llojë të gjendjës aktuale a. Ka nevojë për me e pasë familje strehuese,a ka fëmijë që kan mbetë dhe ky plan veprimi qka do të shërbejë,a mundet dikush me na dhën sqarim.

Avni Bytyqi-është e domosdoshme që Komuna me pasë një planë të tillë për arsye që edhe ligji për asistencë sociale e parashehë që Komuna me pasë një planë të tillë,ky ka të bëj me familjet të cilët i marrin dhe i strehojnë fëmijët të cilët mbesin pa prind,nëse nuk gaboj i kemi dy familje në Fshatin Mushtishtë të cilët po merren me rritjen e këtyre fëmijëve dhe pikërisht kjo e ka edhe një kosto financiare dhe që këtë vit ka insistu qendra për punë sociale që ta ketë këtë kosto por përshkak të mungeesës së buxhetit dhe përshkak të vështirësive buxhetore që kemi këtë vitë nuk ka mujtë Kryetari Komunës me nda buxhet,ndërsa vitëve të tjera po besoj që ka me u rritë kjo vlerë për arsye se me të vërtetë nuk është e lehtë

me strehu fëmijën e huaj dhe me rritë ,kërkesa edhe e grupit dhe ekspertëve të jashtëm ka qenë që familjet që do të rrisin këta fëmijë të shkojnë për trajnime dhe të specializohen dhe njëkohësisht ti njihet si profesion për rritjen e këtyre fëmijëve.

Urim Suka-nuk po e kam të qartë qka nënkupton kjo me ju njoftë si profesion, a ka me kan si vendë pune dhe a është e mundëshme që ne përmes kësaj qka po e miratojmë tash,dhe Komuna a e ka këtë mundësi me bo?

Avni Bytyqi-e kam lexu dhe analizu këtë plan, kjo e ka kuptimin nëse këta shkojnë trajnim dhe Komuna e ka kapacitetin financiar dhe ne udhëheqim trajnime tilla dhe ata specializohen për këtë qështje nga ekspert të fushave caktume,normale që ka me ju njoftë si profesion ,mirpo kur i marrin nëpër institucione së paku kan një dokument që jan të trajnuar.

Urim Suka-ky plan veprimi,a i trajton njësoj si fëmijët që adaptohen në farefis me fëmijët që adaptohen në familje strehuese apo kan dallim,dmth a e gëzojnë këtë 150€ pasi që e lexova në material që 11 raste jan të adaptuar në farefis dhe 1 rast i adaptuar në familje strehuese.

Avni Bytyqi-Komuna i subvencion vetëm rastet kur janë të adaptuar në familje strehuese dhe jo në farefis.

Urim Suka-te plani veprimit që e keni bë te objektivat me sa pashë jan të planifikuara 16.000€ për subvencionimin 150€ nëse është vetëm 1 raste nuk vlenë të shpenzohet.

Avni Bytyqi-ato nuk janë vetëm për subvencionim e familjeve strehuese por edhe për qështjen e organizimit të trajnimeve profesionale.

Dardan Berisha-përshendetje për të gjithë,ne jemi tu e kalu një plan veprimi afatshkurtë dhe është dashtë me paas edhe një raport për gjendjen aktuale se qysh është qyteti jonë dhe nuk e dijë sa është koefidenciale kjo apo mundet me qenë edhe publike por nëse është e mundëshme në mbledhjen e rregullt me pas një raport nga Drejtoresha.

Sanie Kuqi-Rexhepaj-Përshendetje për të gjithë,është mirë në të dy format me u subvencionu,qoftë në farefis apo në familje vullnetare sepse asnjëra palë nuk i kan prindërit,por e kan ndjeh obligim moral me u kujdes për ata fëmijë dhe pse mos me u subvencionu edhe këta në farefis.Krejt në këtë diskutimin tonë ne jemi tu e pa të arsyeshme që me u trajtu të barabart,ku do që jan duke u strehu dhe me vendim të Kuvendit me u subvencionu me faza mujore por nëse ka raste më të rënda dora e shtetit dhe e Kryetarit me kan plus mbështjete,mirpo me hy në sistem dhe Komuna me pas regjistër të krejtë këtyre familjëve dhe nëse paraqitet familje e re automatikisht me hy në sistem të pagesave dhe jo vetëm me kërkesa individuale të familjëve.

Liridon Fandaj-përshëndetje për të gjithë,unë i kam nxjerrë do vrejte në kuadër të këtij plani,e para është financimi dhe qëndrueshmëria buxhetore nuk ka naj plan të detajuar për këtë sa kushton një kosto ose nindiqka dhe që është vështir nëse nuk e ke një plan buxhetor dhe me bë zbatimin e saj,tjetëra është kapacitet njerëzor që qendra për punë sociale aktualisht i ka vetëm 5 persona në plan përfshihet që monitorimin duhet me bë kjo qendërështë kogja barrë e madhe për qendrën me bo minitorimin e këtij plani veprimit,3 mekanizmat e monitorimit ose raportimit-nuk përmendendet kërkun në këtë plan veprimi që duhet me raportu qoftë në KPF apo në Kuvend sepse ne po e kalojmë këtë planë,qyshka me u zbatu kjo pjesë.4 Përfshirja me partnerë lokal-e parashehë bashkpunimin me SOS fshatrat dhe OJQ të ndryshme por nuk e ka të qartë cili është bashkpunimi meto.Një tjetër aspekt që këtu është aspekti ligjor administrativ janë të propozuara disa lirime nga pagesat komunale por këtu nuk parashihet që këto duhet me i kalu Kuvendi Komunal dhe në aspektin ligjor ky plan veprimi nuk i parasheh se qysh ka me i kalu nëse një kategori bën lehtësira ajo duhet me ardhë në Kuvend Komunal,kështu që në bazë të këtyre vërejteve ky plan veprimi mirë që është bër por nëse nuk korigjohet dhe nuk parashihen këto faza është vështirë i zbatuar dhe mbetet vetëm si një dokument që e kemi kalu na.

Kryesuesi-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 3 Shqyrtimi i projekt-Rregullores për bonuset e zonimit për Komunën e Suharekës;

Kryesuesi-laboron pikën dhe hap debatin

Urim Suka-Nuk ka fjalë që nuk e kemi thënë është e 4 herë dhe po të vjenë keqë kur po vjen kështu kaq shpesh dhe unë uroj që i keni numrat dhe e kaloni, se nëse nuk i keni numrat dhe nuk kalon kjo është vetëm një llojë përpjekje e një situatë ku ne po e bëjmë deri këtu dhe kta nuk po e votojnë, llojë politike me një gjë që është e ndihshme.

Sanie Kuqi-Rexhepaj-përkundrazi diskutimet unë mendoj që duhet me u bërë, por duhet me u bërë diskutimet konstruktive se ne i kemi paraqit disa kërkesa dhe kemi thënë që ne e kemi vullnetin me votu por këto duhet me u inkadru në rregullore ose duhet ne me u ulë me diskutu pse spo munen këto qëndrime tona me u inkadru në rregullore, dhe mungesa e moskumunikimit dhe bashkëpunimit kemi ardhë në këtë pikë ku jemi, kështu që është një lloj presioni dhe është si lloj shantazhi sepse tri herë e ka marrë një verdik, dhe tash po e lidhi me çështjen e Kuvendit të Kosovës vendimi i Kushtetues a vlen njëjtë edhe për këtë sepse unë e kam bërë dhe një pyetje Sa herë duhet me sjellë një dokument që e ka marrë një verdik nga Asambleja?, Kushtetuesja për Kuvend thotë tri herë pse te ne vjen për herë të katërt.

Avni Bytyqi-Nuk ka të bëjë kurgjo me këtë rregullore, pamvarsisht pse janë shpallë zgjedhjet në fund institucionet kanë me funksionu normal, sikurse të mos ndodhë asgjë përpos atyre çështjeve që janë të rregulluara me ligj, dhe ligji për të cilat i ka kufizuar dhe specifikuar që as Kuvendi dhe as Kryetari Komunës nuk mund të marrë vendim deri në konstituimin e organeve të reja. Kryetari Komunës së bashku me Kuvendin dhe njësit përgjegjëse ka me funksionu normal deri në konstituimin e organeve të reja dhe krijon efekt juridik sikurse të mos ndodhë asgjë, dhe përderisa i përket se sa herë ka të drejtë asnjë ligj asnjë rregullore as rregullorja e punës së Kuvendit nuk e rregullon se sa herë ka të drejtë Kryetari Komunës me e sjellë një propozim në Kuvend për ta miratuar, ka të drejtë aq herë deri të ju bind apo deri sa ta bindeni ju Kryetarin e Komunës që të bën ndryshime ashtu siç e kërkon Kuvendi, nuk ka asnjë ligj apo rregullore që e rregullon çështjen.

Urim Suka-një pyetje për zyrtarin ligjorë, në momentin kur shpallen zgjedhjet sipas ligjit nuk ka të drejtë Kuvendi Komunal me marrë vendime për me dhënë prona në shfrytëzim një lloj situatë është edhe kjo rregullore?

Avni Bytyqi-nuk ka të bëjë me pronën.

Liridon Fandaj-rregullorja si e tillë nuk ka ndryshu asgjë është një presioni dhe unë atë ditë në Asamble kam kërku nga zyrtari ligjor edhe konfliktin e interesit, po na shtini në lajthitje me gjithë kolegët e mi sepse ne kemi ardhë aty me i mbrojtë të drejtat e qytetarëve, nëse dikush bën matematika se ne kemi lyp vetëm ndryshime me pas dhe nëse dikush për interesa personale del bisedon me bizneset dhe thotë ne po e kalojmë por spo e kalon LVV ose LDK kjo është absurde se ne skemi interes e ata që jan tu manipuluar me këtë duhet me shku në përgjegjësi.

Kryesuesi-e hedhë në votim pikën 3

4 vota për, 3 kundër miratohet pika 3

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-31320;

Kryesuesi-laboron pikën dhe hap debatin

Liridon Fandaj-ky vendim atëherë kur është miratuar, unë nuk e kam kundërshtuar si vendim në Asamble por e kam thënë që mënyra e vlerësimit me një vendim paraprak është pak e mangët sepse nuk mundemi të njëjtën pronë Komunale ose është në vend më të qëllim në qytet kjo pronë është dhënë me një % më të ulët se sa një pronë tjetër dikun, dhe nuk e kam thënë që ky vendim duhet të shfuqizohet vetëm kam thënë që interesi publik po dëmtohet. Në bazë të takimeve dhe personave që janë të lidhur me këtë i janë drejtuar zyrës ligjore dhe Drejtorisë së Urbanizmit, ata i kanë thënë që Liridoni i ka dërgu shkresë Ministrisë dhe ata e kanë shfuqizuar, vendimi nuk e thotë ashtu vendimi thotë që nuk është specifikuar cili është interesi Komunal, e për vendime të dobëta që i qoni ju atje nuk bën me ja hudhë fajin dikujt tjetër.

Avni Bytyqi-është e vërtetë që kanë qenë por unë i kam treguar vetëm procedurat si janë dhe nëse donë ti unë jam i gatshëm me u ballafaquar me ta dhe unë jap përgjegjësi për secilën vepër timen.

E kena pru me shfuqizua për arsye se jemi në fazën ku kufizohet dhënia në shfrytëzim të pronës sipas ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës pasi që Presidentja i ka shpallë zgjedhjet qëllimisht e kam cekë një pasues të nenit 2 që i referohet shqyrtimi dhe miratimi i raportit dhe rekomandimit të komisionit për këtë deri në konstituimin e organeve të reja që me ja dhënë mundësin kur të bëhet konstituimi i organeve të reja ne me e shqyrtua këtë raport, a miratohet a nuk miratohet është çështje e Kuvendit,dhe ne mundemi me e sjellë 20 herë këtë raport mirëpo verdikti final i këtij raporti është i Kuvendit nuk është i Kryetarit.

Urim Suka-vendimet që ne i marrim në Kuvendin e Komunës i nënshtrohen ligjshmërisë dhe tash nëse Ministria thotë nuk ka shkuar sipas procedurës ligjore qysh ne mundemi me vazhdu një anshëm.

Avni Bytyqi-nëse e vlerësoni ju dhe sponzorizuesi ju bind juve që ne e kemi mirë dhe ju e vlerësoni dhe e mendoni që e keni mirë vetëm me një ngritje dore e miratoni në fuqi vendimi dhe e konstatojmë në proces verbal që ne e kemi mirë vazhdojnë procedurat,dhe tani vazhdojnë procedurat gjyqësore dhe tani Gjykata vendos kush e ka pas mirë.

Kryesuesi-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 5. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Suharekës për vitin 2024;

Kryesuesi-laboron pikën dhe hap debatin

Bulëza Kuçi-ky raport paraqet krejtë atë që ndërvite e paraqesim në Asamble mirpo unë dua vetëm disa pika me i theksu psh te shkeljet e rënda ligjore në 15 raste me vlerë 305.000€ janë ndryshuar fondët e projektëve kapitale pa aprovimin e Kuvendit pra Kryetari ka anashkaluar Kuvendin dhe qytetarët,në prokurim janë përmendur emra prodhimësh duke dëmtuar konkurrencën dhe duke i favorizuar operatorë të caktuar,tek subvencionët janë shpërndarë sera për fermerë të cilët nuk i kanë plotësuar kushtet ligjore duke i diskriminuar ata të cilët i kanë pas dokumentet në rregull,shumë e shumë shkelje të tjera,mos kujdes për pasurit publike ku mbi 1309 njerëz që janë tatimpagues nuk figurojnë me nr personal në bazën e të dhënave,tek dëshmitë në projektet kapitale kisha theksu që projektet e mëdha si Kolektori në rrugën Skenderbeu,Sheshi Brigada 123 ende të pa përfunduar, ka zyrtarë që janë paguar pa evidencë të vijshëmërisë në punë deri në 12 orë.Ky raport është ndër më të dobët deri tash.

Liridon Fandaj-ky raport është një opinion i kualifikuar që dëshmonë mangësi serioze në menaxhimin e financave dhe ne se kemi këtu as Drejtorin e Fincave as Zyrtarin Kryesor Financiar e as Kryetarin e Komunës në mesin e krejtë kësaj është keq që nuk dalin në opinion dhe me trregu për të gjeturat dhe gabimet që janë.Ky raport është dashtë me ardhë në fund të qershorit për diskutim sepse në Majë është përfundu ky raport.

Urim Suka-Raporti i Auditorit është raport vjetor dhe është obligim ligjor me ju drejtu Asamblesë dhe normalisht që ne e japim mbështetjen që kjo me shku në Asamble dhe me u diskutu,ajo që shumicën e senev edhe Bulëza i tha ky komision është i kualifikuar dhe gjetjet janë koga serioze dhe shqetësimi më i madh është që ka gjetje që përseritën vazhdimisht dhe kjo e tregon atë mos vullnetin e juaj që edhe ato gjetje kur i jep mos me i përmirësu dhe kjo e bën më shqetësuese situatën.Ne e kemi pritë që ky raport vjenë në qershor dhe është pak sa i vonuar dhe ne mendojmë që në seancën e Asamblesë do ta japim fjalën për gjetjen që i ka dhënë Auditori. Në shumicën e këtyre gjetjeve ne e kemi pasë fjaalën në Asamble ,ne kemi folë për mungesën e projektëve, ne kemi fol për cilësinë,ne kemi fol për anashkalimin e vendimeve të Asamblesë dhe tash i ki këto gjetje këtu dmth nëse pak të na kishit ndëgju neve për ato kritika që i kemi dhënë ndoshta ky raport kish dalë më i mirë.

Kryesuesi -e hedhë në votim

5 vota për, 0 kundër,1 Abstenim miratohet pika 5

Takimi përfundoi 11:05